



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 405/1 prot.

Tiranë më 18.3.2021

Lënda: Përgjigje lidhur me kërkesën për dhënie mendimi

INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 1596/1 Prot., datë 04.03.2021, me anë të së cilës kërkohet mendimi lidhur me Projektregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në vijim gjeni qëndrimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”).

Zyra e Komisionerit e vlerëson si mjaft të rëndësishëm bashkëpunimin me institucionin tuaj, nisur nga rëndësia dhe specifikat e proceseve përpunuese, të dhënave personale, subjekteve të të dhënave personale dhe objektivat që synohen të realizohen në zbatim të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në referim të nenit 3/5 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, institucioni juaj konsiderohet kontrollues. Për pasojë veprimtaria juaj përpunuese duhet të kryhet në respektim të parimeve, kritereve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale të sanksionuara nëpërmjet këtij ligji specifik dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga Komisioneri.

Vlen të theksojmë se përmbajtja e Projektregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, implementon parimet e mbrojtjes së të dhënave personale (sipas nenit 5 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar) dhe në të njëjtën kohë përpunimi i të dhënave kryhet për interesa publike dhe qëllime të ligjshme siç është verifikimi i ankesave, hetimi i shkeljeve disiplinore dhe fillimi i procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe inspektimi institucional i gjykatave dhe zyrave të prokurorisë (referuar Nenet 194 “Objekti i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”).

- Konstatohet pasaktësi lidhur me numërizimin e neneve pasi mungon neni 19 dhe rezultojnë dy nene 20.
- Në nenin 20 “Përpunimi i të dhënave në sistemin e video survejimit”, të Projektregullores, vlerësojmë të parashikohen profilet e punonjësve që kanë akses në sistemin e video-surveimit dhe afati specifik i ruajtjes së të dhënave në këtë sistem, në zbatim të Udhëzimit nr. 3, datë 05.03.2010, të Komisionerit, mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.
- Referuar nenit 22 “Personi i Kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale” vlerësojmë si vijon:
 - Në pikën 1, ju bëjmë me dije se Udhëzimi nr.21 i Komisionerit është shfuqizuar. Në këtë kuadër sugjerojmë që të referohet Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018, të Komisionerit, për “Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”;
 - Detyrat e Personit të Kontaktit parashikohen më gjerësisht në pikën 34 të Kapitullit VI të Udhëzimit nr.47. Në këtë kuadër mbetet në vlerësimin tuaj referimi në rregullore i këtyre parashikimeve (më konkretisht detyrimin për mbikëqyrjen e brendshme të detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Sugjerojmë që në kuadër të garantimit të nenit 18 të Ligjit, të hartoni dhe të publikoni në faqen tuaj zyrtare “Politikën e privatësisë” e cila ka si synim informimin e subjekteve të të dhënave personale dhe publikut të gjerë për fushën dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave personale (për çdo proces përpunimi), funksionarët që kryejnë përpunimin dhe mënyrat e kontaktit (jo emrat por funksionin, psh në këtë rast Personi i Kontaktit), mënyra e përpunimit (shkurtimisht), të drejtat që gëzojnë subjektet e të dhënave (nenet 12-17 të Ligjit) dhe masat teknike organizative për sigurinë e të dhënave (shkurtimisht pasi me gjerësisht i ka rregullorja e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale).

Për t’ju ardhur në ndihmë lidhur me hartimin e “Politikës së Privatësisë”, sugjerojmë që t’i referoheni Opinionit të Zyrës së Komisionerit “Opinion mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqet e internetit të kontrolluesve publik dhe privat” publikuar në faqen zyrtare, në linkun:

http://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/11/opinion_mbi_mdhp_ne_faqet_e_internetit-1.pdf

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



KOMISIONERI

Besnik Dervishi